- Rritja e kontrollit dhe llogaridhënies institucionale
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe logjistikës
- Forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e situatave emergjente shëndetësore

3.2 Sektori i Mirëqenies Sociale

- Ofrimi i shërbimeve sociale të integruara dhe gjithëpërfshirëse
- Mbrojtja e kategorive të ndjeshme dhe rritja e mbështetjes sociale
- Përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional

4. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

- QKMF – Hani i Elezit ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për popullatën e komunës. Nga analiza e vitit paraprak janë identifikuar këto nevoja kryesore:
- Nevoja për përmirësim të cilësisë së shërbimeve
- Rritje e aktiviteteve parandaluese
- Menaxhim më i strukturuar i sëmundjeve kronike
- Mungesë e stafit shëndetësor në disa profile
- Nevoja për investime kapitale dhe pajisje mjekësore

5. OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET KRYESORE

5.1 Kontrolli dhe Monitorimi i Brendshëm

- Ushtrimi i kontrollit permanent të brendshëm në QKMF dhe AMF
- Rritja e monitorimit të respektimit të orarit të punës dhe disiplinës profesionale
- Marrja e masave ndëshkuese konform legjislacionit ndaj rasteve të mosrespektimit

5.2 Menaxhimi i Pandemive dhe Emergjencave Shëndetësore

- Ngritja e gatishmërisë institucionale për menaxhimin e situatave emergjente
- Koordinim i vazhdueshëm ndërinstitutional me:
- QKMF
- IKSHPK
- Ministrinë e Shëndetësisë
- Zbatim i masave parandaluese dhe politikave shëndetësore në fuqi

5.3 Përmirësimi i Shërbimeve Shëndetësore

- Implementimi i plotë i konceptit të Mjekësisë Familjare
- Shtimi i stafit shëndetësor në profilet deficitare
- Ofrimi i shërbimeve:

- Mjekësi familjare
- Shëndeti i gruas
- Vizita shtëpiake për të moshuar dhe pacientë kronikë
- Referime në nivelin sekondar dhe terciar

6. PROMOVIMI DHE PARANDALIMI

Edukim shëndetësor për:

- Hipertension
- Diabet
- Shëndet riprodhues
- Ushqyerje të shëndetshme
- Fushata vetëdijesimi për:
- Vaksinim
- Ndërprerje të duhanit
- Aktivitet fizik

7. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- Trajnime të vazhdueshme për mjekë dhe infermierë
- Mbikëqyrje dhe mentorim profesional
- Vlerësim vjetor i performancës së stafit
- Rritje e numrit të punëtorëve shëndetësorë sipas nevojës

8. ADMINISTRATA DHE LOGJISTIKA

Ndërmarrja e procedurave të prokurimit për:

- Investime kapitale (infrastrukturë e QKMF-së dhe AMF-së)
- Pajisje mjekësore dhe materiale shpenzuese
- Furnizim i rregullt me barna

- Kontraktim për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore
- Asgjësimi i barnave të skaduara në bashkëpunim me MSh

9. SIGURIA DHE CILËSIA

- Zbatim i protokolleve klinike standarde
- Audit klinik i brendshëm së paku dy herë në vit
- Monitorim i ankesave të pacientëve
- Kontroll i rregullt i higjienës dhe parandalimit të infeksioneve

10. PLANI KOHOR

- Janar – Mars: Planifikim dhe trajnime
- Prill – Qershor: Edukim shëndetësor dhe audit klinik
- Korrik – Shtator: Vizita shtëpiake dhe menaxhim i sëmundjeve kronike
- Tetor – Dhjetor: Raportim dhe vlerësim vjetor

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Zbatimi i planit do të monitorohet përmes:

- Raporteve mujore
- Raporteve tremujore
- Raportit vjetor, i cili i dorëzohet Drejtorisë Komunale dhe Kuvendit Komunal

12. PËRFUNDIM

Zbatimi i këtij Planit Vjetor të Punës do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e shëndetit të popullatës së Komunës së Hanit të Elezit, në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe në forcimin e rolit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si institucion kyç në shërbim të qytetarëve.

Sektori i mirëqenies sociale

Qendra për Punë Sociale do të veprojë dhe punojë për realizimin e planit për vitin 2026 në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutin e Komunës, Statutin e QPS-se dhe ligjeve të tjera që e rregullojnë fushën e Mirëqenies Sociale me qëllim ofrimin të shërbimeve sa më afër dhe më të mirë për të gjithë qytetarët:

Qendra për Punë Sociale

Do të jetë në shërbim gjatë gjithë kohës në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Shërbime sociale për të gjitha kategoritë që kanë nevojë për ndihmë .

Mbajtja e Tryezave për Menaxhimin e Rasteve me qëllim mbrojtjen e fëmijëve .

Bashkpunim me mjetet e informimit për sensibilizim të projektit për “Strehim Familjar” për fëmijët e braktisur dhe ata të strehuar tek të afërmit .

Shërbime psiko-sociale që përfshijnë ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe sociale nga punonjësit sociale dhe sipas mundësive buxhetore nga psikologët .

Përkujdesje dhe vizita të vazhdueshme për fëmijët jetim dhe ato me aftësi të kufizuar.

Mbajtja e ligjeratave për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve .

Bashkpunim me QKMF, DKA për mbajtje të ligjeratave në shkolla.

Ndihma sociale për familjet në nevojë duke u bazuar në ligjet në fuqi.

Zbatimin e Ligjit të SNS-së nr.2003/15 si dhe ndryshimit dhe plotësimit e këtij ligji nr.04/L096.

Zbatimin e legjislacionit të aplikueshëm për shërbimet sociale dhe familjare, si dhe doracakëve dhe standardeve të aprovuara për mbrojtjen e fëmijëve e kategorive tjera sociale.

Bashkëpunim i ngushtë me Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe Gjykatat e Kosovës.

	Bashkëpunimi me DSHMS-së, MPMS, organizatat qeveritare jo qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare. Raportimi i rregullt për nevojat e DSHMS-së, MPMS. Menaxhimi i punëve dhe detyrave të punës për të gjithë stafin.
--	---

Kimete Kuka Hasallari

Drejtoreshë e DSHMS-së

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit, vitin 2026, do ta vazhdojë me të njejtin organizim sektorial: Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtja e Mjedisit si dhe me të njejtin numër të stafit:

- Katër zyrtar Kadastral,
- Dy zyrtar Urbanizmi,
- Një inspektor Mjedisi dhe
- Drejtori i DUKMM.

Buxheti i planifikuar i Drejtorisë për vitin 2026 është:

- Paga dhe Meditje:	80,230€
- Mallra dhe shërbime:	20,000€
- Shpenzimet kapitale:	425,480€
Gjithësejt Buxheti	525,710€

SEKTORI I URBANIZMIT

- Objektivat kryesor të sektorit të Urbanizmit për vitin 2026 do të jenë:

- Realizimi i plotë i listës së projekteve kapitale të miratuara nga Kuvendi Komunal për vitin 2026 dhe projektet e bartura nga viti 2025,
- Demolimi i lokaleve me përmbajtje azbesti në zonën qendrore të Hanit të Elezit,
- Përfundimi i hartimit të Hartës Zonale të Komunës dhe miratimi i të njejtës nga Kuvendi i Komunës,
- Vazhdimi i implementimit të Ligjit të legalizimit të objekteve pa leje ndërtimore,
- Menaxhimi i pronës Komunale,
- Trajtimi i banesave Kolektive sipas Ligjit në fuqi,
- Mbështetja profesionale të gjithë sektorëve dhe drejtorive të Komunës,
- Mbështetja profesionale Kuvendit Komunal, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, FSK, PK, Gjykatës, KFORIT-it etj,
- Përgjigjia në të gjitha llojet e kërkesave ndaj personave fizik dhe juridik.

PROJEKTET KAPITALE PËR VITIN 2026

Puna jonë kryesore për vitin 2026, do të jetë në përgaditjen e dokumentacionit për projekte të ndryshme investive duke filluar nga përgaditja e projekteve ideore e gjerrë në finalizimin e plotë të projektit (projekti zbatues, si dhe pjesmarrja në vlerësimin e ofertave, mbikqyrjen profesionale të punimeve gjatë realizimit të tyre si dhe pjesmarrjen në procesin e vlerësimit dhe pranimin teknik të punimeve). Në këtë drejtim dinamika e punës së këtij sektori do të ndikohet nga lista e projekteve investive për vitin 2026, të miratuara nga Kuvendi Komunal gjatë vitit të kaluar si dhe hartimi i projekteve të reja të cilat do të gjejnë zbatim vitin 2027.

Më poshtë po japim listën e projekteve kapitale për realizim vitin 2026 të miratuar nga Kuvendi Komunal:

Nr.	PROJEKTET KAPITALE	BUXHETI	REALIZIMI
1.	Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik faza II	694.000	Maj-Shtator
2.	Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotoreve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seqishtë, Dimcë, Pusteni, Gorancë, Dromjak, Rezhancë, Krivenik	70,000	Korrik-Gusht
3.	Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në f. Paldenicë, Pusteni, Seqishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	60,000	Gusht-Tetor
4	Ndërtimi i mureve mbrojtëse Lagjia e re dhe në f. Paldenicë, Dromjak, Pusteni, Seqishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	50,000	Gusht-Tetor
5.	Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, shtëpia e kulturës-Imri Curri, Oborri i Komunës, stadiumi i qytetit Suad Brava- shpronsim	80,000	Maj-Korrik
6.	Mjete të lira për bashkëinvestime	10,000	Qershor-Korrik
7.	Rregullimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbrim) në rrg. Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Han të Elezit dhe rrg. Gafur Loku f. Paldenicë	20,000	Maj-Korrik
8.	Ndërtimi i trotoreve për këmbësor në Han të Elezit në rrg. Adem Jashari, Udhë e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë	25,000	Korrik-Shtator
9.	Rregullimi i rrugës Fujza-Vërtomicë	15,480	Gusht-Shtator
10.	Ndërtimi i rrugës Nënberg f. Seqishtë	20.000	Shtator-Nëntor
11.	Ndërtimi (shtrimi me zhavorr) i rrugës Seqishtë-Vorba	30.000	Gusht-Tetor

12.	Shtrimi me zhavorr i rrugës prej burimit të f.Seqishtë deri te Lloka	20.000	Gusht-Shtator
13.	Shtrim me kubëza betoni të rrugës që lidh fshatin Rezhancë me varrezat	25.000	Gusht-Tetor

HARTA ZONALE E KOMUNËS

Meqense ka përfunduar dhe është miratuari Plani Zhvillimor i Komunës 2025-2033, Drejtoria e Urbanizmit, në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor do të vazhdoj procedurat e përfundimit të hartimit dhe miratimit të Hartës Zonale të Komunës. Ky dokument i rëndësisë së veçantë për komunën pritët që të përfundoj nga fundi i verës të vitit 2026.

LEGALIZIMI I OBJEKTEVE PA LEJE NDËRTIMORE

Me projekt-ligjin e ri për ndryshimin dhe plotesimin e ligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndertimeve pa leje, gjegjësisht në nenin 13 paragrafi 1 parashihet që afati për legalizimin e ndertimeve pa leje ndërtimore të vlejë deri më 31.12.2025 viti. Bazuar në faktin se ky afat ka përfunduar, Drejtoria e Urbanizmit do të vazhdoj me trajtimin e aplikimeve për legalizim të ndertimeve pa leje ndërtimore për rastet të cilat janë në listë të pritjes (rastet të cilat kanë probleme me prona dhe e kanë afatin ligjor prej dy viteve për rregullimin e dokumentacionit).

PËRGJIGJIA NË TË GJITHA LLOJET E KËRKESAVE NGA PERSONAT FIZIK DHE JURIDIK

Në adresë të Drejtorisë sonë vazhdimisht vijnë shumë lloje të kërkesave nga ana e qytetarëve dhe personave juridik siç janë: kërkesa për leje ndërtimore, kërkesa për dhënjë pëlqimi, leje të ndryshme shfrytëzimi etj. Drejtoria jonë është e gatshme që duke respektuar ligjet në fuqi ti përgjigjet në mënyrë efikase këtyre kërkesave dhe gjithmonë në bashkpunim të ngushtë me Drejtoritë tjera si dhe stafin udhëheqës të Komunës.

SEKTORI I KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Objektivat kryesorë të këtij sektori për vitin 2026 janë:

Mirëmbajtja dhe azhurnimi i operatit Kadastral,

Implementimi dhe zbatimi i ligjit mbi themelimin e regjistrit të së drejtës së pronës së paluajtshme,

Rregullimi i qështjeve pronësore juridike sipas dispozitave ligjore në fuqi,

Implementimi i Kadastrit të banesave,

Inçizimi sipas nevojave dhe regjistrimi i rrugëve dhe objekteve publike të Komunës në Kadastër,

Trajnime profesionale për zyrtarët e Kadastrit,

Mbështetje profesionale Kuvendit Komunal, AKK-së, FSK, PK, Gjykatës, KFOR-it etj.

Bashkpunimin e ngushtë me Agjencionin Kosovar të Kadastrit lidhur me problematikën në fushën e Kadastrit dhe Gjeodezisë.

MBROJTJA E MJEDISIT

Objektivat kryesorë të sektorit të mjedisit për vitin 2026 janë:

Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2021-2026 si dhe Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2024-2029,

Implementimi i plotë i ligjeve në fuqi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit,

Ndërmarrjen e masave parandaluese përmes inspektimeve të rregullta dhe aplikimit të masave ndëshkuese ndaj gjithë atyre që ndotin mjedisin, Bashkpunimi i ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (inspektorët mjedisor) si dhe Policinë e Kosovës, Paisja e bizneseve me pëlqime dhe leje mjedisore etj.

Gjithashtu, vemendje e veçantë do ti kushtohet dhe senzibilizimit të mbrojtjes së mjedisit, organizimit të aksioneve të rregullta të pastrimit, organizimin e aksionit për shënimin e ditës ndërkombëtare të Tokës -22 Prilli, aksioni “Ta pastrojmë Kosovën” etj.

Drejtori i DUKMM

Nexhmedin Daci

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

Bazuar në rregulloret në fuqi dhe në statutin e komunës së Hanit të Elezit neni 77, ku me këtë nen është e përcaktuar veprimtaria e kësaj drejtorie, ku për këtë drejtori ne kemi planifikuar punët dhe detyrat Janar – Dhjetor 2026.

Ne si drejtori do të fokusohemi:

- Në plotësimin e stafit të kësaj drejtorie,
- Në krijimi i kushteve të volitshme për stafin, dhe
- Në shtimin e efikasitetit të punës në këtë drejtori.

Struktura organizative e Drejtorisë (skema)

- Drejtori drejtorisë së DSHPE-së(1)
- Udh. i Sektorit të Shërbimeve Publike(1)
- Inspektori i Komunikacionit (ins.Ndërtinmit-punë shtesë).....(1)
- Inspektor i ndërtimeve.....(0)
- Zyrtar i Hapësirave Publike.....(1)
- Njësia profesionale e zjarrfikësve dhe shpëtimit.....(5+1)

Buxheti i Planifikuar i Drejtorisë për vitin 2026

Paga dhe mëditje	89,028.00 €
Mallra dhe shërbime	110,000.00 €
Shpenzime kapitale	120,000.00 €
Subvencionet dhe transferet	15,000.00 €
Shpenzime Komunale	3.000.00 €
Gjithsej buxheti	337,028.00 €

SHPENZIME KOMUNALE

Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Fondi 10 GQ	Vlera €
-----	--------------------------	-------------	---------

<u>1.</u>	<u>Furnizim me dru për zjarr shtëpinë e zjarrfikëseve</u>	<u>1000.00</u>	<u>1000.00</u>
<u>2.</u>	<u>Pagesën e mbeturinave për NJPZSH</u>	<u>156.00</u>	<u>156.00</u>
<u>3.</u>	<u>Shpenzimet e Rrymës për NJPZSH</u>	<u>600.00</u>	<u>600.00</u>
<u>4.</u>	<u>Pagesa e ujit për NJPZSH</u>	<u>360.00</u>	<u>360.00</u>
<u>5</u>	<u>Shpenzime tjera</u>	<u>884.00</u>	<u>884.00</u>
	<u>TOTALI</u>	<u>3000.00</u>	<u>3000.00</u>

SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

<u>Nr</u>	<u>Përshkrimi i shpenzimit</u>	<u>Fondi 21 -THV</u>	<u>TOTALI</u>
<u>1</u>	<u>Shpenzimet e Varrimit</u>	<u>15,000.00</u>	<u>15,000.00</u>

Investime Kapitale

NR	Kodi	Programi/Përshkrimi i Projektit	10-GQ	21-THV	TOTALI 2026
<u>1.</u>	I RI	Ndërtimi i rrjetit elektrik nëntokësor në zonën urbane të Hanit të Elezit (Rr.Dëshmorët e Kombit, Rr.Xhemsedin Suma, Rr.Nuri Bushi, Rr.Imri Curri)	.00	20,000.0	20,000.00
<u>2.</u>		Ndriçimi publik në fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Rezhancë, Paldenicë, Dermjak	20,000	00.00	20,000.00
<u>3.</u>		Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik	20,000.	0.00	20,000.00
<u>4.</u>		Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	10,000	15,000	25,000.00
<u>5.</u>		Ndërtimi (ngritja e deponisë) për mbetje të ngurta (inerte)	15,000	0	15,000.00
<u>6.</u>		Rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Dromjak, Seçishtë, Krivenik, Dimcë, Paldenicë, Pustenik dhe Rezhancë	10,000	10,000	20,000.00
		TOTALI	75,000	45,000	120,000

NR	Plani i shpenzimeve për vitin 2026 Janar-Dhjetor - F10 –F21	10-GQ	21-THV	TOTALI
----	---	-------	--------	--------

1	Mirëmbajtja e ndriçimit publik	13,000.00	2,000.00	15,000.00
2	Shërbime Saldimi	4,000.00	-	4,000.00
3	Hartimi i Planit Emergjent	3,000.00	-	3,000.00
4	Shërbimet e internetit për zjarrfikësit	240.00	-	240.00
5	Karburant për vetura	1,000.00	-	1,000.00
6	Mirëmbajtja e kanalizimit fekal dhe atmosferik	7,000.00	-	7,000.00
7	Regjistrimi i veturave të zjarrfikëseve	1,100.00	-	1,100.00
8	Mirëmbajtja e rrugëve verore dimërore, mirëmbajtja e varrezave , hapësirave publike	77,860.00	-	77,860.00
9	Mirëmbajtjen e ndërtesave	800.00	-	800.00
	TOTALI	110,000	2000	110,000

OBJEKTIVAT E DREJTORISË

- Objektivat e kësaj drejtorie janë :
- Ngritjen e kapaciteteve në DSHPE,
- Përmbyshja e të gjitha obligimeve legjislativë që rrjedhin nga dispozitat ligjore të nivelit qendror, komunal dhe nga statuti i miratuar i komunës sonë, në përgatitjen dhe hartimin e dispozitave ligjore si dhe në zbatimin e tyre,
- Reagim të shpejt dhe efikas të ekipeve emergjente, si të nivelit lokal edhe të atij qendror qeveritar ndaj rasteve emergjente , si: zjarreve të ndryshme , aksidente komunikacioni, aksidente teknologjike dhe fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera,
- Hulumtimin e burimeve të reja për ujë të pijshëm,
- Bashkëpunimi me njësinë e bifurkacionit në Han të Elezit për menaxhimin e ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Formimin e ekipeve vullnetare kundër zjarrit gjatë muajve të verës, kur në ato kohë temperaturat e larta të nxehtësisë mundë të shkaktojnë dhe përhapjen e zjarreve,
- Ngritja e vetëdijesimit për mbrojtje nga zjarret, për qytetarët me anë të :- bisedave me qytetarët dhe broshurave duke kërkuar mbështetje nga Agjencinë e Menaxhimit Emergjent,
- Vazhdimin e bashkpunimit me GIZ-in Gjerman duke theksuar Eficientë e Energjis,përkrahjen teknike në fushën e menaxhimit të mbeturinave, duke apikuar edhe në

projekte të ndryshme si psh .Gara në mjedis të pastër,furnizimin me kontenjer, kamion dhe pajisje tjera të nevojshme për mbrojtjen e ambientit etj.

- Miratimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave me regjionin e Ferizajit dhe Anamoravës
- Hrtimin e planit të rrezikut, emergjent etj
- Vazhdimin e bashkëpunimit me Kforin Italian , Polak etj
- Bashkëpunimi me kompaninë publike komunale NPL“Pastrimi”Sh.a duke e zbatuar edhe marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve të lidhur në mes komunës dhe kompanisë,
- Mirëmbajtjen e rrugëve ,trotareve, ujësjellësit ,kanalizimit, ndriçimit publik, hapësirave publike , shenjëzimin , fushat e sportit të hapura etj.,
- Dekorimin e qytetit për festat e fund vitit,
- Mirëmbajtjen dhe riparimin e ulëset, pasqyrat rrugore , shportat e mbeturinave, etj. të cilat kanë të bëjnë me shërbime saldimi,
- Pastrimin e deponive ilegale,,
- Bashkëpunimin me drejtorin komunal për të realizuar me sukses planet dhe projektet të cilat dalin nga Drejtoria e DSHPE-së,
- Bashkëpunimi me fabrikën e çimentos Sharr cem për thithjen e donacioneve të cilat janë me interes për Drejtorin dhe komunitetin,
- Përmirësimin dhe pastrimin e rrjetit të kanalizimit fekale ,atmosferik në zonën urbane dhe rurale në territorin e Komunës së Hanit të Elezit,
- Heqjen(konfiskimin) e panove reklamues për kompanitë të cilat nuk kryejnë pagesën e paraparë me rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa administrative.
- Spërkatjen me insekticid bimët dekorative ,
- Bashkëpunim me KEDS-in për ndërrimin e shtyllave elektrike të drurit në të gjitha vendbanimet dhe të cilat shtylla përbëjnë rrezik për banorët e Hanit të Elezit,
- Ndalimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore,
- Inspektimin e punimeve në teren gjatë ekzekutimit të projekteve nga inspektori i ndërtimit duke bashkëpunuar ngushtë me zyrën e projekteve,
- Shenjëzimi horizontal -vertikal në territorin e komunës së Hanit të Elezit,
- Hulumtimin e një lokacioni për deponimin e mbeturinave nga ndërtim demolimi në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanizmit dhe drejtorit tjera,

PËRGJIGJEN NDAJ EMERGJENCAVE

- Alarmimin dhe informimin e popullatës
- Kërkim-shpëtimin
- Evakuimin
- Strehimin dhe
- Dhënien e ndihmës mjekësore dhe humanitare
- Shtimi i efikasitetit në koordinimin e punës në raste emergjente me :
- Policinë e Kosovës (PK)
- Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)
- KFOR-in

- Axhencin për Menaxhimin Emergjent(AME)

NJËSIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Në mungesë të numrit të zjarrfikësve, shërbimi i zjarrfikësve do të punojë me dy ndërrime, ndërsa gjatë sezonit të verës do të punohet në dy ndërrime dhe me orë kujdestarie në ndërrimin e tretë.

Reagimet emergjente në parandalimin e krizave, shuarjen e zjarreve, vërshimeve si dhe të të gjitha fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera do të bëhen në mbështetje të akteve normative dhe dokumenteve:

- Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera (FNFT).
- Ligjit për mbrojtje nga zjarri.
- Statuti i Komunës.
- Plani i reagimit emergjent.
- Urdhëresave dhe qëndrimeve të organeve të Komunës së Hanit të Elezit,
- Kontrollime dhe inspektime nga zyrtari parandalues për marrjen e masave parandaluese ndaj zjarrit në objekte të rëndësisë së veçantë në komunën tonë.
- Përcjellja e trajnimeve të ekipeve të shpëtimit të shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimit, sipas Ligjit ne fuqi.
- Bashkëpunimi me departamentin për siguri në punë në fabrikën e çimentos “Sharr cem” duke realizuar skenarët e mundshëm të fatkeqësive të ndryshme,
- Sektori për mbrojtje dhe shpëtim në nivel të lartë gatishmërie, të shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimit për intervenime ndaj zjarrit dhe formimi i njësive vullnetare për shpëtim nga zjarret dhe fatkeqësi natyrore në përputhshmëri me ligjin për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera.

INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

- Përmirësimin e infrastrukturës së komunikacionit duke krijuar kushte më të volitshme në trafikun rrugor të Hanit të Elezit, sinjalizimin horizontal dhe inspektimin e vazhdueshëm të taksive dhe eliminimin e taksive ilegal duke bashkëpunuar me policin e stacionit policor në H-E,
- Mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit dhe të emërtimit të rrugëve ,
- Mirëmbajtjen e parkingjeve publike dhe të pikë ndaljeve të stacionit të autobusëve,
- Inspektimin e vazhdueshme të kombi busëve të cilët operojnë në komunën e H-E,

INSPEKTORI I NDËRTIMIT

- Do të mbikëqyr të gjitha ndërtimet sipas ligjit ,
- Do të evidenton ndërtimet ilegale ,
- Do të inspekton projektet në teren gjatë ekzekutimit të punimeve.
- Do të kryen punë të tjera me interes për institucionin.

ZYRTARI PËR HAPËSIRA PUBLIKE

- Do të Përgatitë lëndët dhe merr pjesë në procedimin e të gjitha kërkesave për dhënie e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, të cilat janë të parapara në rregulloren për tarifa dhe gjoha për shërbime Publike,
- Do të bashkëpunon me administratorët e fshatrave, ndërtesave kolektive për qështje të banimit duke krijuar data bazën për të gjitha ndërtimet e banimeve kolektive në komunë;
- Do të regjistron, mirëmban dhe përditëson të dhënat në regjistër që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e hapësirave publike;
- Do të mbikëqyr kompaninë e cila merret me mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave të dëshmorëve, të qytetit, kanalet e hapura dhe të mbyllura,
- Merr masa ndëshkues për keqpërdoruesit të cilët derdhin në hapësira publike; ujin, ujërat e zeza, betonin nga betonierat,
- Merr masa ndëshkuese për personat të cilët dëmtojnë në çfarëdo forme objektet me interes të përgjithshëm (drunjtë dekorativ, ulëset e parqeve, shtyllat e ndriçimit publik, shportat e mbeturinave, shenjat e komunikacionit, lodrat argëtuese për fëmijë , sipërfaqet e gjelbëruara publike etj..)
- Trajtimi dhe ndalimi i kyçeve ilegale në ujësjellës,
- Të gjitha kyçet ilegale në Han të Elezit, do të trajtohen duke u bazuar në rregulloret e komunës së Hanit të Elezit,
- Marrja e masave ndaj hedhjeve të mbeturinave në hapësira publike dhe vende ilegale,
- Heqjen e mbeturinave nga deponit e egra ilegale,
- Mirëmbajtjen e deponisë të mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi,

BASHKPUNIMI I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

- Do të bashkëpunojmë me ministrinë përkatëse(MPB) dhe Axhencin për menaxhimin emergjencave (AME) ,PK,FSK,OSBE,KFOR,QKMF, NPL PASTRIMI SH.A , dhe Drejtorit Komunale.
- Do të bashkëpunojmë me drejtorit e tjera komunale të komunave të Kosovës për të shkëmbyer praktikat e mira për zhvillim të komunës në drejtorinë e shërbimeve publike dhe me drejtorit tjera.

Drejtori i DSHPE-së
Senad Kalisi

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

VIZIONI PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Hani i Elezit do të formësohet si nyje në ekonominë rajonale, e cila do të shfrytëzojë shtrirjen gjeografike të saj dhe këtë zgjerim do ta ketë edhe jashtë kufijve, duke harmonizuar dhe stimuluar një frymë të rëndësishme në aspektin e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor, aspekt ky që do të ndërtohet mbi trashëgiminë natyrore, kulturore, arkitektonike, mundësive zhvillimore ekzistuese dhe atyre të reja nëpërmjet politikave transparente duke zgjeruar horizontet në shumë sektorë.

STAFI I DREJTORISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

Zyrtari për Regjistrim të Bizneseve

Zyrtari për Zhvillim Ekonomik

Inspektori i Tregtisë

Drejtoresha e Drejtorisë

BUXHETI I DREJTORISË

BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR VITIN 2026						
NËNPROGRAMI	EMËRTIMI	PAGA DHE SHTESA	MALLRA DHE SHËRBIME	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI 2025
48035	ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM	39,842.00 €	9,000.00 €	25,000.00 €	177,000.00 €	247,850.00 €

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

- PROMOVIM I POTENCIALEVE ZHVILLIMORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NË RAJON
- ZHVILLIMI I PIKAVE ME POTENCIAL TURISTIK
- ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

OBJEKTIVA I: PROMOVIMI I POTENCIALEVE ZHVILLIMORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NË RAJON

<i>Aktivitetet e planifikuara</i>	<i>Intervali kohor</i>	<i>Vendi</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Implementues</i>
<i>Organizimi i Panairit tradicional lokal me punime artizanale</i>	<i>Korrik - Gusht</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Promovim i punës tradicionale dhe bizneseve vendore</i>	<i>DZHET</i>
<i>Organizim të trajnimeve dhe punëtorive me fokus ekonominë dhe turizmin</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Vetëdijësim dhe dhënie e informatave në favor të komunitetit</i>	<i>DZHET</i>
<i>Hartimi i dokumenteve informative dhe prezantimi i tyre përmes kampanjave, webfaqeve promovuese dhe eventeve</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Promovimi i potencialeve në rajon me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja</i>	<i>DZHET</i>
<i>Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare</i>	<i>Prill - Qershor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Promovim i potencialeve vendore në panairë të huaja</i>	<i>DZHET</i>

OBJEKTIVA II: ZHVILLIMI I PIKAVE ME POTENCIAL EKONOMIK DHE TURISTIK

<i>Aktivitetet e planifikuara</i>	<i>Intervali kohor</i>	<i>Vendi</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Implementues</i>
<i>Rregullim i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe në fshatrat përreth</i>	<i>Mars - Tetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Përmirësim dhe nxitje të bashkëveprimit social, hapësirë për të gjithë grupmoshat, përmirësim të mjedisit ambiental dhe shëndetësor</i>	<i>DZHET</i>

<i>Krijimi i shtigjeve të ecjes nëpër zonat rurale</i>	<i>Mars - Tetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Përmirësim dhe nxitje të bashkëveprimit social, hapësirë për të gjithë grupmoshat, përmirësim të mjedisit ambienta dhe shëndetësor</i>	<i>DZHET</i>
<i>Rregullimi i hapësirës turistike në Skollovac</i>	<i>Prill - Shtator</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Krijimi i hapësirave turistike dhe shfrytëzimi i potencialeve natyrore</i>	<i>DZHET</i>
<i>Ndërtimi i Tregut Ditor të qytetit</i>	<i>Prill - Korrik</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Përmirësim i zhvillimit ekonomik lokal dhe ofrimi i kushteve më të mira për tregti lokale</i>	<i>DZHET</i>
<i>Ndërtimi i Sheshit të Qytetit</i>	<i>Qershor - Dhjetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Krijimi i zonave rekreative dhe sociale për qytetin dhe hapësira të reja për dhënie në shfrytëzim</i>	<i>DZHET</i>

OBJEKTIVA III: ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

<i>Aktivitetet e planifikuara</i>	<i>Intervali kohor</i>	<i>Vendi</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Implementues</i>
<i>Shpërndarja e informatave për biznese</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Informata rreth procedurave administrative dhe ligjore</i>	<i>DZHET</i>
<i>Shpërndarja e aktvendimeve</i>	<i>Mars - Prill</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Inkasimi të hyrave vetanake për ushtrim të veprimtarisë së bizneseve</i>	<i>DZHET</i>

<i>Mbështetja/subvencionimi i bizneseve fillestare</i>	<i>Prill - Maj</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Mbështetje për bizneset fillestare me qëllim të zhvillimit në vend</i>	<i>DZHET</i>
<i>Monitorimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Hanit të Elezit</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Monitorimi dhe implementimi i projekteve të listuara në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik</i>	<i>DZHET</i>
<i>Krijimi i bashkëpunimeve ndërkomunale dhe ndërkufitare</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Bashkëpunime të ndërsjellta me qëllim zhvillimin në vend</i>	<i>DZHET</i>
<i>Angazhimi i praktikantëve të rinjë në sektorin e zhvillimit</i>	<i>Mars - Maj</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Angazhimi me qëllim të përfitimit të përvojës institucionale dhe përgatitja për treg të punës</i>	<i>DZHET</i>
<i>Hartim i programeve për ringjalljen e zanatave të vjetra</i>	<i>Shtator - Tetor</i>	<i>Komuna Hani i Elezit</i>	<i>Ruajtja e vlerave trashëguese, krijimi i bashkëpunimit social ndërmjet grupeve të caktuara, krijim i frymës për ushtrim të veprimtarisë</i>	<i>DZHET</i>

Majlinda Kaloshi

Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në fushë veprimtarinë e vet të gjerë përfshin aktivitete të ndryshme dhe të shumta. DBPZHR-ja – për shkak të aktiviteteve të shumta e të ndryshme ndahet në dy sektorë:

- Sektori i Bujqësisë
- Sektori i Mbrojtjes

SEKTORI I BUJQËSISË

Objektivat kryesore të sektorit të bujqësisë për vitin 2026 janë:

- Hartimin e planeve për zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Hanit të Elezit.
- Ruajtja e tokave bujqësore nga degradimi fizik, kimik dhe ndërtimet në tokat bujqësore.
- Inkurajimi i fermerëve duke i nxitur në investime për rritjen e kapaciteteve prodhuese bujqësore.
- Bashkëpunon me AVUK-in për mbrojtjen e kafshëve shtëpiake, shpendëve, bletë etj. nga sëmundjet.
- Hartimin e programeve për orientimin drejt bujqësisë organike, e cila mundëson jo vetëm prodhimin e ushqimit ekologjik dhe të shëndetshëm por edhe mbrojtjen e resurseve natyrore.
- Përkrahje e fermerëve në : mbjelljen e kulturave lavërtarie , blegtori, pemëtari, perimtari, bletari, shpeztari etj, si dhe subvencionimin e tyre.
- Përkrahja e grave që merren me bujqësi dhe inkurajimin e tutjeshëm të tyre në përfshirjen e aktiviteteve bujqësore. Organizimi i trajnimeve /këshillimeve të vazhdueshme me fermerët për ngritjen e prodhimtarisë bujqësore (prodhimtaria intensive).
- Promovimi i produkteve bujqësore vendore të fermerëve tanë përmjet panairit tradicional Hani i Elezit që organizohet në kuadër të komunës, si dhe nëpërmjet panaiereve të organizuar nga MBPZHR-ja.

SEKTORI I MBROJTJES

Objektivat e kryesore në sektorin e mbrojtjes gjatë vitit 2026:

- Mbrojtja e florës dhe faunës (mbrojtja nga gjuetia e pa kontrolluar si dhe peshkimin nëpër lumenj dhe përroskat).
- Zbatimi i kontratës për gjueti e kontraktuar për 10 (dhjetë) vitet e ardhshme në territorin e Hanit të Elezit me shoqatën e gjahtarëve “Syri i Shqiponjës” .
- Përcaktimi i Vend gjuetisë për kafshë i paraparë sipas Ligjit për gjueti- Ligji Nr. 02/L-53 sidhe LIGJI NR. 02/L-85 PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË.

PLANI I DREJTORISË PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURALI SIPAS MUAJVE:

Nr	Aktivitetet e planifikuara	Koha e aktivitetit	Vendi i aktivitetit	Implementuesit e aktiviteteve
1	Thirrje për aplikim për ndihmë të fermerëve me subvencione nga MBPZHR-ja në ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agro-rural. Masa2: Pagesa direkte për dele, dhi, bletë, lopë, pula, të mbjellura me grurë, misër, arra, lajthi, molla etj.	Janar-Shtator 2026	Zyra e Bujqësisë	-Komuna Hani i Elezit -Sektori i Pylltarisë -APK-Ferizaj
2	Thirrje për aplikim për ndihmë të fermerëve me subvencione nga MBPZHR-ja në ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agro-rural. Masa2: Ndërmarrjet bujqësore për prodhim të qumështit.	Janar-Shtator 2026	Zyra e Bujqësisë	-Komuna Hani i Elezit -Sektori i Pylltarisë -APK-Ferizaj
3	Përpilimi i raportit 6 mujor dhe vjetor të punës së drejtorisë.	Janar-Dhjetor 2026	Komuna Hani i Elezit	-DBPZHR
4	Kërkesa për ndërrim-destinim të tokës bujqësore dhe pyjore dhe shfrytëzim të tokës.	Janar-Dhjetor 2026	Komuna Hani i Elezit	Kuvendi Komunal dhe Drejtoria përkatëse

5	Thirrje për aplikim për ndihmë të fermerëve dhe ekonomive bujqësore. Masa1: Pagesa direkte	Mars-Shtator 2026	Zyra e Bujqësisë	-MBPZHR -DBPZHR
6	Hapja e fushatës “Korrje-Shirje 2026”	Korrik 2026	Territori i Hanit të Elezit	-Komuna Hani i Elezit -MBPZHR
7	Raportimi mbi fushatën e korrje-shirjeve 2026	Korrik-Gusht 2026	Territori i Hanit të Elezit	-AVUK-u dhe -DBPZHR
8	Shpërndarja e aseteve dhe kulturave bujqësore të planifikuara nga OJQ-LAB për vitin 2026	Maj - Nëntor 2026	Territori i Hanit të Elezit	-Komuna Hani i Elezit -Sektori i Pylltarisë APK-Ferizaj
9	Mbështetje të investimeve në Masën8: Strategjitë për zhvillim lokal të bazuar në komunitete –Përkrahje për zhvillimin e komunitetit lokal përmes GLV-ve(Grupe lokale të veprimit).	Maj-Shtator 2026	Bizneset e vogëla dhe të mesme Komuniteti OJQ-të	-Komuna Hani i Elezit- -Sektori i Pylltarisë dhe -APK- Ferizaj
10	Thirrje për aplikim për fermerët dhe ekonomitë bujqësore. Mbështetje për investimenë. Masa 2:Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural. Përnën-masën 3,4 dhe 5 përSektorin e Pemëtarisë,Perimekulturës dhe Vreshtarisë.	Mars–Shtator 2026	Zyra e Bujqësisë	-Komuna Hani i Elezit -DBPZHR

11	Aplikim për pagesa direkte nga MBPZHR-ja për mbjellje vjeshtore-grurë, misër, dredhëz, mjedër,etj.	Janar- Maj 2026	Zyra e Bujqësisë	-Komuna Hani i Elezit -DBPZHR
12	Subvencionim nga Drejtoria e BPZHR-së .	Prill – Dhjetor 2026	Zyra e Bujqësisë	-Komuna Hani i Elezit -Fondacioni -OJQ –LAB-i
13	Panairi i produkteve bujqësore lokale Hani i Elezit 2026	Qershor- Gusht 2026	Komuna Hani i Elezit	-Komuna Hani i Elezit -MBPZHR -MAPL-ja -AZHR Lindje
14	Rrallimet e pyjeve të ulta	Prill - Dhjetor 2026	Njësia menaxhuese “Uji i Bardhë”	-Komuna Hani i Elezit -MBPZHR

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:

Abduraman Bushi

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	I	II	III	IV	V	VI	VI	VII	IX	X	XI	XI	
							I	I				I	
Identifikimi, ruajtja, mbrojtja dhe prezantimi i Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Hanit të Elezit	I përhershëm												DKRS
17 Shkurt; Përgatitja për kremtimin e "17 Shkurtit" - Dita e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës Organizim i garave në sport kolektiv		√											DKRS – SHKA “Sharri”
26 Shkurt; Ora e parë e mësimin në të gjitha shkollat i kushtohet 26 Shkurtit-Veprës së lavdishme të UÇK-së.		√											DKRS & DKA
21 Mars ; Dita botërore e poezisë			√										DKRS & DKA

27 Mars; Dita botërore e muzeut													
29 Mars; Dita e SHFMU "Ilaz Thaçi"													
Takime me Institutin Arkeologjik të Kosovës rreth relikteve të gjetura në vendbanimet e komunës së Hanit të Elezit dhe mundësia e hulumtimit të mëtejme në pronat e identifikuara	Në vazhdimësi												DKRS & IAK-së (Institut i Arkeologjik i Kosovës)
06 Prill; Dita ndërkombëtare e sportit				√									DKRS &DKA
09.10 Prill "Bllaca 99"													
15 Prill ;Dita botërore e artit													
23 Prill; Dita botërore e librit													
29 Prill; dita botërore e vallëzimit													
4 Maj; Dita e SHFMU "Kështjella e Diturisë"					√								DKRS &DKA

10 Maj; Dita e SHFMU "Dardania"					√								DKRS &DKA
18 Maj ; Dita ndërkombëtare e Muzeut					√								DKRS &DKA
Ditët e kulturës 01-12 Qershor 11 Qershor; "Dita e Çlirimit" në Komunën e Hanit të Elezit. "Festival folklorik" Organizimi i garave në sport individual dhe kolektiv						√							DKRS –SHKA "Sharri"
Korrik; Takim me Bashkatdhetarët, program kulturor për nder të tyre							√						DKRS –SHKA "Sharri"
12 Gusht; Dita e rinisë 29 Gusht; Dita e Dëshmorëve në Komunën Hani i Elezit.								√					

Program kulturor dhe artistik													DKRS –SHKA ”Sharri”
28 Nëntor; Dita e Flamurit. Program kulturor dhe artistik Organizim i garave në sport kolektiv											√		DKRS –SHKA ”Sharri”
14 Dhjetori; Dita e SHFMU ”Veli Ballazhi”												√	DKRS & DKA

Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport

Arbenita Bajramaliu